

01-1107



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika "d" e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-150519/23 dt. 20.07.2023, të kërkuësve / Investitorit N.T.N.“Tregtia” sh.p.k. me seli në Fushë Kosovë, rr. “Nëna Terezë”, nr. 280, me numër unik identifikues 81002448, dhe me pronar Bedri Prishtina nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesat “R10/02”, “R10/03”, “R10/04/05”, “R10/06”, dhe “R10/07”, të ndërtuara, në kuadër të bllokut urbanistik “R10”, të Planit Rregullues të Hollësishem, për blloqet B17, B18, B19, dhe B20 – Lagja “Mati 1” 2017-2015, në rr. “Beteja e Loxhës”, “Lavdie Lusha” dhe “Çuka” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 20.05.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkuësit / Investitorit N.T.N.“Tregtia” sh.p.k. me seli në Fushë Kosovë, rr. “Nëna Terezë”, nr. 280, me numër unik identifikues 81002448, dhe me pronar Bedri Prishtina nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-150519/23 dt. 20.07.2023, përdorimi i ndërtesave shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa “R10/02” me etazhitet 4B+P+4, ndërtesa “R10/03” 4B+P+6, ndërtesa “R10/04/05” me etazhitet 4B+P+6, ndërtesa “R10/06” me etazhitet 2B+P+10, dhe ndërtesa “R10/07” me etazhitet 2B+P+8, të ndërtuara sipas Vendimit për Lejimin e Ndërtimit, 05 Nr. 351/02-0155336/18 dt. 19.10.2018, në parcelën kadastrale nr. 1830-1, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-01830-1, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të blloqeve urbane “B17”, “B18”, “B19”, dhe “B20”, të Planit Rregullues të hollësishem, në Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Beteja e Loxhës” ku kanë dalje hyrjet me numrat: 9, 11, 13, 15, 17, 19, 21, 23, 25, dhe 27, dhe në rrugën “Lavdie Lusha”, ku kanë dalje hyrjet me numrat: 1, 3, 5, si dhe në rrugën “Çuka”, ku kanë dalje hyrjet me numrat: 6, 8, 10, 12, 14, 16, 18, 20, 22, dhe 24, në Prishtinë, dhe e njejta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të tyre në evidencat e regjistrimit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkuësi / investitori N.T.N.“Tregtia” sh.p.k. me seli në Fushë Kosovë, rr. “Nëna Terezë”, nr. 280, me numër unik identifikues 81002448, dhe me pronar Bedri Prishtina nga Prishtina, me kërkesën 05 Nr. 391/02-150519/23 dt. 20.07.2023, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa “R10/02” me etazhitet 4B+P+4, ndërtesa “R10/03” 4B+P+6, ndërtesa “R10/04/05” me etazhitet 4B+P+6, ndërtesa “R10/06” me etazhitet 2B+P+10, dhe ndërtesa “R10/07” me etazhitet 2B+P+8, e ndërtuara, në kuadër të blloqeve urbane “B17”, “B18”, “B19”, dhe “B20”, të Planit Rregullues të hollësishem, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1830-1, ZK Matičan, ndërtuar sipas Vendimit për Lejimin e Ndërtimit, 05 Nr. 391/02-230369/22 dt. 24.05.2023, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit, e Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-230369/22 dt. 21.10.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e

Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Arbnore Aliçkaj; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Arban Limani; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Fatlind Sadikaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikqyrësi Osman Mehmetukaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Gazmend Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të mbrojtjes nga zjarri, nga mbikqyrësi Arban Limani; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompania e licensuar gjeodeze me nr. të licensës 46;

Drejtorja e Urbanizimit, pas pranimit të kësaj kërkesë dhe shqyrtimit të saj, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat shumëbanesore me afarizëm mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.


Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certifikate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikatë. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,

05 NR. 391/02-150519/23 DT. 20.05.2024

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaj


Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi

